

**URDHËR**  
**Nr.142, datë 13.5.2020**

**“PËR PËRCAKTIMIN E ADRESAVE TË POSTËS ELEKTRONIKE PËR  
KOMUNIKIMIN ZYRTAR ME MINISTRINË E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37, pika i, të ligjit nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, me qëllim lehtësimin e procedurave të komunikimit me përmbartuesit privatë,

**URDHËROJ:**

1. Çdo përmbartues gjyqësor privat, si dhe çdo zyre përmbartimore, të depozitojë pranë Ministrisë së Drejtësisë, një adresë të postës elektronike, funksionale.

2. Çdo ndryshim i adresës së postës elektronike të sipërcituar duhet të njoftohet, brenda dy ditëve punë nga kryerje e këtij ndryshimi pranë Ministrisë së Drejtësisë, elektronikisht në adresën e administruar nga struktura përgjegjëse e rregullimit të profesioneve të lira, me qëllim përcjelljen e këtyre komunikimeve dhe me shkresë.

3. Përmbartuesi gjyqësor privat apo zyra përmbartimore regjistron këtë të dhënë dhe çdo ndryshim të saj në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës.

4. Çdo komunikim elektronik i Ministrisë së Drejtësisë që lidhet me ushtrimin e profesionit të përmbartuesit gjyqësor privat, të kryhet përmes kësaj adrese elektronike.

5. Me dërgimin e komunikimit në adresat e postës elektronike të përcjella, do të konsiderohet se njoftimi është kryer.

6. Në rast të mungesës së njoftimit nga përmbartuesi gjyqësor privat mbi ndryshimin e adresës së postës elektronike, të parashikuar në pikën 2 të këtij urdhri, njoftimi do të konsiderohet i kryer në adresën e deklaruar më parë prej tij.

7. Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, të marrë masa për zbatimin e këtij urdhri dhe të përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë një listë të përditësuar me adresat elektronike për përmbartuesit, brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

8. Ngarkohet struktura përgjegjëse e monitorimit/rregullimit të profesioneve të lira, në Ministrinë e Drejtësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**